



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:019124

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06735756

KF.nr.894/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin administrativ, të paditësit “Kulla Exim” Sh.P.K. me numër unik identifikues 810216491, me seli në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike - anulim vendimi, objekt kontesti Taksa e Akcizës, vlerë kontesti e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të mbajtur, me datë 13.01.2025, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit G. B. dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur M. K., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Kulla Exim” Sh.P.K. me numër unik identifikues 810216491, me seli në Pejë.
- II. ANULOHET vendimi nr. 01.3.2.2/10124 i datës 05.07.2022 i Doganës së Kosovës dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi “Kulla Exim” Sh.P.K. me seli në Pejë, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 29.08.2022, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, për anulimin e vendimit 01.3.2.2/10125 të datës 05.07.2022, për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabueshëm të dispozitave materiale të Kodit Doganor. I ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin aprovet në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit

dhe të anulohet në tërësi si i pabazuar aktvendimi i Doganës së Kosovës 01.3.2.2/10124 i datës 05.07.2022. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e autorizuar e paditësit deklaroi se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe pranë të gjitha pretendimeve të cekura në të. E paditura sipas aktvendimit të kontestuar paditësit ia ka refuzuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit të lëshuar nga Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve përkatësisht Aneksin II të saj me të cilin paditësit i është mohuar mundësia për të përdorur procedurat më me ndikim ekonomik përkatësisht lirimin e taksës së akcizës për mallin i cili lirohet nga taksa sipas vendimit të Qeverisë. Në padinë drejtuar kësaj gjykate në mënyrë të hollësishme janë cekur pretendimet e paditësit. Në aktvendimin e kontestuar thuhet se sektori i procedurave ka vepruar drejtë kur ka pezulluar Aneksin II të vendimit të ATK-së, mirëpo e paditura nuk e ka arsyetuar faktin se pse ky veprim duhej të ndërmerrej pasi ky veprim i të paditurës për paditësin ka qenë një veprim i cili i ka kushtuar zhvillimit të aktivitetit të tij tregtar pasi aktivitetin të cilin e ka zhvilluar paditësi nuk mund të zhvillohet pa përdorur autorizimet dhe lirimin nga taksa e akcizës për mallin lëndor i cili është përdorur si lëndë e parë. Ka shtuar se e paditura nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka paraqitur prova me të cilat e mbështet vendimin e saj. Gjykaës i ka propozuar që të veprojë sipas kërkesëpadisë dhe këtë lëndë të kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 02.10.2024 e konteston në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktvendimit kontestues, konsideron se ky aktvendim është marrë tërësisht bazuar në kodin doganor dhe të akcizave si dhe në gjetjet e cekura në aktvendimin kontestues nga komisioni i formuar enkas për këtë çështje të evidentuar në raportin e datës 29.03.2022 i cili bazohet në rekomandimin 01/1161/2021. Ka shtuar se në këtë raport janë kontestuar normativat e shpenzimit të vajit të rëndë për ngrohje të përdorura në procesin e prodhimit në lidhje me mallin me kodin tarifar 27101967, andaj edhe është vendosur për pezullimin e lirit të Aneksit II të vendimit 208/2020. Pra në situatën konkrete kemi vetëm një pezullim, ndërsa sektori i procedurave dhe autorizimeve bazuar në gjetjet që do të bëhen do të vendos për çështjen kontestuese. Dogana nuk mund të vendos ndryshe dhe kjo procedurë nuk mund të vazhdohet deri sa Ministria e Tregtisë ka vendosur që

t'i revokojë lejet për subjektin "Kulla Exim" me vendimin 01 ref. 80/2022 i datë 15.04.2022 marr licencën për importin. Bazuar në thëniet e cekura më lart dhe sqarimeve që janë dhënë në përgjigjen në padi dhe provave të bashkangjitura në këtë lëndë e paditura i propozon gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin e refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe e lë në fuqi aktvendimin e kontestuar si të drejtë dhe të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, ka administruar provat dhe atë: Aktvendim 01/3/2/2/10124 datë 05.07.2022, Aktvendim 04.1.5/6513/30.03.2022 datë 07.04.2022, Aneksi II, Ankesë në doganë datë 18.05.2022, Vendim 01.ref.80 datë 15.04.2022, Rekomandim për pezullim të autorizimit datë 30.03.2022, Rekomandim për pezullim të lirimit nga taksa e akcizë për vaj të rëndë për ngrohje 29.03.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga Aktvendimi 04.1.5/653 i datës 30.03.2022 i lëshuar nga Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve, i Doganës së Kosovës, deklarimeve në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi ka ushtruar ankesë ndaj vendimit të lartcekur për faktin se me të njëjtin është pezulluar Aneks 2 i vendimit 208/2020 për lirim të tatimit në akcizë si burim energjie për mallrat me numrin tarifor 27101967 me përshkrim vaj i rëndë për ngrohje- mazut, procedura LPN dhe është obliguar që të ndërpres shfrytëzimin e lirimit të tatimit të akcizës për këtë mall. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë ndaj vendimit të lartcekur, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 05.07.2022, ka marr Aktvendimin nr. 01.3.2.2/10124 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin është refuzuar kërkesa e subjekti në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës 29.08.2022, ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, për rishqyrtimin e vendimit 04.1.5/6513 të datës 30.03.2022 të lëshuar nga Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve. E paditura ka vlerësuar se Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve ka vepruar drejtë kur ka pezulluar ANEKS-2 të Vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës 208/2020 për lirim të tatimit të akcizës si burim energjie për mallrat me numrin tarifor 27101967, me përshkrimin vaj i rëndë për ngrohje – mazut, procedura LPN, si dhe ka obliguar subjektin ankimor që të ndërpres shfrytëzimin e lirimit të tatimit të akcizës si burim energjie sipas Aneks 2 për mallrat me numrin tarifor 27101967 me përshkrimin vaj i rëndë për ngrohje – mazut, procedura LPN deri në njoftimin tjetër. Tutje është deklaruar se vendimi mbështetet ne rekomandimin e Sektorit të Akcizës nr.04.1.5 Nr.6513/30.03.2022 i cili ka kontestuar normativat e shpenzimit të vajit të rëndë për ngrohje dhe nevoja e përdorimit të tyre në proces të prodhimit andaj është rekomanduar pezullimi i Aneks 2 të vendimit nr.208/2020 procedura LPN deri në saktësinë e procesit të prodhimit në Autorizimin PKD dhe normativit të shpenzimit të “vajit të rëndë për ngrohje” dhe proces të prodhimit.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, te metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna te pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket pezullimit të Aneksit 2 të vendimin nr.208/2022 të ATK-së. Në arsyetim të vendimit kontestues, thuhet se Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve ka vepruar drejtë kur ka pezulluar ANEKS-2 të Vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës 208/2020 për lirim të tatimit të akcizës si burim energjie për mallrat me numrin tarifor 27101967, me përshkrimin vaj i rëndë për ngrohje – mazut, procedura LPN, si dhe ka obliguar subjektin ankimor që të ndërpres shfrytëzimin e lirimit të tatimit të akcizës si burim energjie sipas Aneks 2 për mallrat me numrin tarifor 27101967 me përshkrimin vaj i rëndë për ngrohje – mazut, procedura LPN deri në njoftimin tjetër. Mirëpo një konstatim i tillë për Gjykatën është tërësisht i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në KDAK 03/L-109, përderisa e paditura është mjaftuar vetëm me rekomandimin nr.04.1.5 nr.61513/30.03.2022, i cili rekomandim është mbështetur në raportin e komisionit sipas vendimit 01.1161/2021, të cilin raport, e paditura nuk e ka sjell si provë në këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata ka shqyrtuar po ashtu bazën ligjore në të cilën është mbështetur e paditura dhe konstaton se Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës, neni 249 paragrafi 1 parasheh: “1. Në

rastet kur konsiderohet e domosdoshme të veprojë ashtu për ta ruajtur akcizën që paguhet apo duhet paguar, Dogana mund ta refuzojë kërkesën për autorizim, miratim ose leje, që kërkohet sipas këtij neni dhe ta revokojë ose pezullojë autorizimin, miratimin apo lejen e dhënë.” Ndërsa neni 15 paragrafi 2 i këtij ligji parasheh: “2. Një vendim në dobi të personit të interesuar mund të revokohet, kur personi të cilit i është adresuar dështon në përmbushjen e obligimeve që lindin nga vendimi në fjalë.”

Neni 249, paragrafi 1 i KDAK-së lejon pezullimin e autorizimeve për të ruajtur akcizën, por në këtë rast nuk është sqaruar se si paditësi ka dështuar të përmbushë obligimet që lindin nga vendimi në fjalë. Po ashtu, neni 15, paragrafi 2, kërkon që revokimi i një vendimi të jetë i bazuar në mosrespektimin e obligimeve nga ana e përfituesit, por ky fakt nuk është vërtetuar. Po ashtu gjykata e ka të paqartë se në cilat dispozita ligjore është mbështetur e paditura kur ka pezulluar vendimin deri në saktësinë e procesit të prodhimit në autorizimin e PKD dhe normativit të shpenzimit të “Vajit të rëndë për ngrohje”. E paditura në vendimin kontestues nuk ka dhënë sqarime në lidhje me faktin se si dhe nga kush realizohet saktësia e procesit të prodhimit si dhe nga cili organ brenda të paditurës Dogana e Kosovës do të nxirret vendimi i radhës dhe sa parashihet të zgjat ky proces.

Gjykata obligon të paditurën që, gjatë rishqyrtimit dhe rivendosjes, të shqyrtojë pretendimet e paditësit dhe të trajtojë vërejtjet e Gjykatës. Të sigurojë një arsyetim të bazuar mbi faktet dhe provat që kanë ndikuar në kontestimin e normativave të shpenzimit të vajit të rëndë për ngrohje dhe nevojën e përdorimit të tyre në procesin e prodhimit. Të sqarojë qartë dispozitat ligjore që mbështesin pezullimin e lirit të akcizës dhe të përcaktojë organin përgjegjës për verifikimin e saktësisë së procesit të prodhimit dhe të normativave përkatëse. Të specifikojë kohëzgjatjen e pezullimit dhe të japë një udhëzim të qartë mbi hapat e mëtejshëm në këtë proces administrativ.

Për më tepër, Gjykata vëren se nga data e pezullimit deri në këtë kontest, Dogana e Kosovës ka pasur kohë të mjaftueshme për të siguruar prova dhe për të përfunduar verifikimet e nevojshme, por ka dështuar të përmbushë këtë detyrim.

Të metat e mësipërme janë të asaj natyre që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj aktvendimi i atakuar u dështë që doemos të anulohet, tutje

Gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të deklarohet edhe lidhur me vërejtjet e dhëna nga Gjykata dhe pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në prova dhe argumente faktike duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Vendimi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KSOSVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.894/22 datë 13.01.2025

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.